

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM**Nr.831, datë 29.7.2009**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 320, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE TË REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja "b", e 32, pika 6, të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 "Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar" dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 "Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 6 të vendimit nr.320, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Një pjesë e këtij fondi, sipas kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të kalojë çdo vit në llogarinë e thesarit të kësaj ministrie, për mbulimin e nevojave vjetore në procesin e matrikullimit.".

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**Copyright 2012 - www.ligjet.org